



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 13886/3 prot.

Tiranë, më 19.12.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1827, datë 07.12.2016.

SHOQËRISË “GENER 2” SH.P.K
ABA Business Center, Floor 7, Rr. Papa Gjon Pali II, Tiranë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Gener 2” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1827, datë 07.12.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtyllë”, Korçë.

Leja minerare nr.1827, datë 07.12.2016 është dhënë mbështetur në bazën ligjore, për veprimtarinë minerare, si karrierë për qëllime publike vendore ose kombëtare, ku në pikat 1 dhe 4, të nenit 23, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar thuhet:

“1. Njësitë e qeverisjes vendore ose institucioni, i cili menaxhon projekte me rëndësi kombëtare, mund t'i propozojnë ministrit miratimin e zonave minerare - karriera, për t'u shfrytëzuar për qëllime publike vendore ose kombëtare, në sipërfaqet në pronësi të njësisë përkatëse”.....

“4. Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare ka afat vlefshmërie jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rinovimi për një vit, sipas kërkesës së zotëruesit, e cila duhet të paraqitet, së paku, 30 ditë kalendarike përpara datës së mbarimit të lejes së mëparshme”.

Me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr.6744/4, datë 11.12.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr.13886/2, datë 11.12.2018, është dërguar Vendimi i Këshillit Teknik nr.605, datë 17.11.2017, “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e procedurave të mbylljes së zonës 371/6, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtyllë”, Korçë, lejen minerare nr.1827, datë 07.12.2016 të subjektit “Gener – 2” sh.p.k”. Vendimi është marrë bazuar në kërkesën e shoqërisë tuaj protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë nr.5591, datë 16.08.2017, “Njoftim për fillimin e procedurave të mbylljes së zonës nr.371/6, objekti “Shtyllë”, Korçë, e cila ishte dërguar për trajtim nga ana e kësaj ministrie, në AKBN, me shkresën nr. 5591/1, datë 08.09.2017.

Kërkesa juaj është e bazuar në germën “a”, të pikës nr.2, neni 47, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe mbështetur në këtë bazë ligjore AKBN-ja ka marrë vendimin, ku miraton projektin e mbylljes e për rrjedhojë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare nr.1827, datë 07.12.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtyllë”, Korçë, por vendimi kushtëzohet me shlyerjen e detyrimit si diferencë e garancisë mjedisore. Që revokimi të kryhet sipas bazës ligjore, që ju referuam në këtë paragraf, duhet që shoqëria të mos ketë detyrime të pashlyera, kështu duhet të paguani një vlerë 109 263 lekë si difference garancie për rehabilitimin e mjedisit, pasi sipërfaqja e prekur nga shfrytëzimi, është me e madhe se ajo për të cilën keni paguar garanci, për rehabilitimin mjedisore të saj, siç përcaktohet në vendimin në fjalë të AKBN-së. Vendimi i AKBN-se është dërguar edhe shoqërisë Tuaj nga ana e kësaj strukture.

Sipas nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1827, datë 07.12.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtyllë” Korçë**, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1827, datë 07.12.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Shtyllë”, Korçë, por nga ana Juaj duhet të kryhet pagesa, që cituam më lart.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

